



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.03.2022)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 17:31 dhe mbaroi në orën 17:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Irena Plaku* (anëtare)
3. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
4. *Ridvan Hado* (anëtar)
5. *Alban Toro* (anëtar)
6. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Klodian Kurushi* (anëtar)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*, znj. *Fatmira Luli*, znj. *Yllka Rupa*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj*, Drejtore pranë Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.

2. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, relator z. Klodian Kurushi.¹

Çështja e cila është për trajtim në rendin e ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi.

Fillimisht zoti Kurushi relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

B. Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Shkodër.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

gjqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z. Arbër Çela.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Sokol Shehu.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, një në lëndë penale dhe një në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e skemës së delegimit të Gjykatës së Apelit Durrës, që janë caktuar më herët për gjykimin e 30 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta, në GJPAKKO dhe në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. {...}.

Në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e mungesës së gjyqtarëve për zhvillimin e shortit, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z.Valbon Çekrezi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale dhe çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Irida Kacerja.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor